



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prilijena/Prodato Received/Delivered	30.03.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKMSTAK	3165/2023		1/8



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.280/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.280/2023 të datës 31.01.2023 të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson nga Prishtina, kundër Vendimit Nr.02/XII/2022 të datës 27.12.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, në çështjen juridike “kundërshtim i masës disiplinore”, duke vepruar sipas nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 30.03.2023, më shumicë votash mori këtë:

### V E N D I M

I. *Refuzohet si e pabazuar* ankesa me numër A.nr.280/2023 e datës 31.01.2023, e parashtruar nga ankuesja

II. *Mbetet ne fuqi* Vendimi Nr.02/XII/2022 i datës 27.12.2022 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë.

### A r s y e t i m

Ankuesja (me tej vetëm ankuesja), e punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë, me datë 31.01.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, e plotësuar dhe ndryshuar me datë 22.02.2023, kundër Vendimit Nr. 02/XII/2022 të datës 27.12.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrinë së Shëndetësisë, me pretendimin se vendimi i kundërshtuar me ankesë derivon me shkelje të dispozitave lidhur me procedurën administrative, është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ dhe është në kundërshtim me ligjin material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në

Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 14.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Shëndetësisë, ndërsa kjo e fundit më datë 28.02.2023, ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokollit 2711 të datës 15.03.2023 ka vazhduar afatin për vendimmarrje lidhur me ankesën A.nr.280/2023 e datës 31.01.2023, edhe për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas konstatimit së ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ka administruar këto prova:** Ankesën me numër protokollit 6207/2022 të datës 14.10.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e Komisionit Disiplinor me numër protokollit 05-4525 të datës 12.09.2022; Ankesën me numër protokollit 1118/2023 të datës 31.01.2023 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Raportin gjashtë mujor i rasteve për vitin 2019, 2020, 2021, dhe 2022-janar-korrik; Raportin sipas rasteve 2019, 2020, 2021, 2022; E-mail nga për datës 07.10.2022; E-mail nga A.P për N.B etj. i datës 18.01.2023; E-mail nga V.E nga F.M etj. i datës 26.01.2023; E-mail nga V.E për F.M etj. i datës 13.01.2023; E-mail nga F.H për F.M etj. i datës 19.01.2023; E-mail nga I.S për M.Gj i datës 20.01.2023; E-mail I.S për i datës 17.01.2023; E-mail nga A.P për N.B etj. i datës 18.01.2023; E-mail nga për etj. i datës 17.01.2023; E-mail nga B.A për F.M i datës 17.01.2023; E-mail nga F.M për B.A i datës 17.01.2023; E-mail nga B.A për F.M i datës 17.01.2023; E-mail nga për i datës 13.01.2023; E-mail nga V.E. për F.M. etj. i datës 13.01.2023; E-mail nga për i datës 27.12.2022; E-mail për P.B i datës 12.01.2023; E-mail nga R.M. për M.Gj. i datës 27.12.2022; E-mail nga V.Z për i datës 12.01.2023; E-mail nga M.Gj për A.Q i datës 26.10.2021; E-mail nga A.Q për M.Gj i datës 26.10.2021; E-mail për B.F i datës 27.10.2021; E-mail nga M.Gj për B.F i datës 02.11.2021; Numri i rasteve të TB-së të të gjitha formave Janar -Shtator, tabela krahasuese 2019-2021; E-mail nga M.Gj. B.F. i datës 27.10.2021; E-mail nga M.Gj për M.Gj i datës 04.07.2019; E-mail nga M.Gj për K.B i datës 18.03.2022; E-mail nga O.K për B.F i datës 16.03.2022; E-mail nga Y.G për O.K i datës 16.03.2022; E-mail nga A.K për O.K i datës 03.03.2022; E-mail nga M.Gj për B.F i datës 21.01.2022; E-mail nga M.Gj për B.F i datës 14.01.2022; E-mail nga M.Gj për N.B i datës 13.01.2022; E-mail nga M.Gj për N.B etj. i datës 13.01.2022; E-mail nga N.B për M.Gj i datës 13.01.2022; E-mail nga M.Gj për O.K i datës 09.08.2022; E-mail nga O.K për M.Gj i datës 09.08.2022; E-mail nga M.Gj për O.K i datës 09.08.2022; E-mail nga M.Gj për A.Q i datës 13.10.2022; E-mail nga M.Gj për M.Gj i datës 13.10.2022; E-mail nga Z.K për M.Gj i datës 13.10.2022; E-mail nga Z.K. për M.Gj. i datës 13.10.2022; E-mail nga M.Gj. për B.F. i datës 11.10.2022; E-mail nga V.Z për M.Gj etj. i datës 03.10.2022; E-mail nga për B.F i datës 19.10.2022; Kërkesë është regjistruar me suksese i datës 19.10.2022; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar Profesional për TBC; Pliko me numër R2743379 i datës 27.01.2023; E-mail nga [ankesa.kpmshck@rks-gove.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gove.net) për M.Gj i datës 31.01.2023; E-mail nga M.Gj për [ankesa.kpmshck@rks-gove.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gove.net) i datës 31.01.2023; Vendim i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë me numër protokollit 05-6910 i datës 27.12.2022; Shkresë nga Institucioni i Avokatit të Popullit me numër protokollit 288 të datës 01.02.2021; Raportin me Rekomandime me numër protokollit 113/2021 të datës 27.01.2021; E-mail nga ankuesja për [ankesa.kpmshck@rks-gove.net](mailto:ankesa.kpmshck@rks-gove.net) i datës 06.02.2023; E-mail nga N.B .datës 22.02.2023; Kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore me numër 05-3996 i datës 12.08.2022; Vendim i KPMSHCK me numër protokollit 7949/2022 i datës 12.12.2022; E-mail nga A.P. për N.B. etj. i datës 18.01.2023;

E-mail nga N.B. për B.A. etj. i datës 17.01.2023; E-mail nga B.A. për F.M. i datës 17.01.2023; E-mail nga F.M. për B.A. i datës 17.01.2023; E-mail nga B.A. për F.M. i datës 17.01.2023; E-mail nga M.GJ. për P.B. i datës 12.01.2023; E-mail nga V.Z. për M.GJ. i datës 11.01.2023; Autorizim nga M.GJ. për M.G. i datës 15.02.2023; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokollit 1743/2023 të datës 14.02.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokollit 2156/2023 të datës 28.02.2023; Akt Emërimi i ankueses me numër 101 i datës 17.09.2012; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën Zyrtar Profesional për TBC (pa datë); Kërkesë për inicimin e procedurës disiplinore me numër protokollit 05-3996 i datës 12.08.2022; Deklaratë me numër protokollit 05-4078 i datës 17.08.2022; E-mail nga A. Q për S. M i datës 03.08.2022; E-mail nga A. Q për M. Gj etj. i datës 20.10.2021; E-mail nga B. F. për A. Q i datës 20.10.2021; E-mail nga G. P. për H. Sh etj. i datës 20.10.2021; E-mail nga M. Gj për A. Q etj. i datës 23.09.2021; E-mail nga A. Q për P. B etj. i datës 22.09.2021; E-mail nga B. F për A. Q i datës 22.10.2021; E-mail nga M. Gj për B. F i datës 20.01.2022; E-mail nga A. Q për S. M i datës 03.08.2022; E-mail nga N. B për A. Q etj. i datës 12.07.2022; E-mail nga D. SH për N. B i datës 12.07.2022; E-mail nga D. Gj për N. B etj. i datës 19.05.2022; E-mail nga D. Gj për M. Gj i datës 22.01.2021; E-mail nga F. F për D. Gj i datës 22.01.2021; E-mail nga A. B për D. Gj i datës 21.01.2021; Raportin mbi fletëporositë e pranuarat i datës 19.05.2022; E-mail nga A. M për M. Gj i datës 16.08.2022; Deklaratën nga ankuesja për Komisionin Disiplinor me numër protokollit 05-4494 i datës 09.09.2022; Inicimin e procedurës disiplinore për Dr. M. Gj i datës 16.08.2022; E-mail nga A. M për P. B etj. i datës 05.09.2022; E-mail nga A. M për A. Q etj. i datës 01.09.2022; E-mail nga B. F për A. M i datës 06.09.2022; E-mail nga A. M për P. B etj. i datës 05.09.2022; E-mail nga A. M për A. Q etj. i datës 01.09.2022; E-mail nga B. F për M. Gj i datës 20.01.2022; E-mail nga M. Gj për B. F i datës 20.01.2022; E-mail nga B. F për M. Gj i datës 20.01.2022; E-mail nga M. Gj për B. F i datës 20.01.2022; E-mail nga B. F për A. Q i datës 28.09.2021; E-mail nga B. F për A. Q i datës 22.09.2021; E-mail nga B. F për A. Q i datës 22.09.2021; E-mail nga B. F për M. Gj etj. i datës 02.11.2021; E-mail nga B. F për M. Gj i datës 21.01.2022; E-mail nga M. Gj për B. F i datës 21.01.2022; E-mail nga B. F për A. M i datës 06.09.2022; E-mail nga A. M për P. B etj. i datës 05.09.2022; E-mail nga A. M për A. Q etj. i datës 01.09.2022; Deklaratën nga P.B për Komisionin Disiplinor, pa datë; E-mail nga H. S për A.M i datës 07.09.2022; E-mail nga A. Q për J. G etj. i datës 06.09.2022; Deklaratën nga A.Q për Komisionin Disiplinor i datës 06.09.2022; E-mail nga P. B për A. M i datës 06.09.2022; E-mail nga A. M për P. B etj. i datës 05.09.2022; E-mail nga A. M për A. Q etj. i datës 01.09.2022; E-mail nga A. M për M. Gj i datës 06.09.2022; E-mail nga M. Gj për A. M i datës 17.08.2022; E-mail nga A. M për M. Gj i datës 16.08.2022; Inicimi i procedurës disiplinore për ankuesen i datës 08.09.2022; Vendimin me numër protokollit 05-2930 të datës 16.05.2014; Vendimin me numër protokollit 05-6910 i datës 27.12.2022 të.... ; E-mail nga M. Z për N. B etj. i datës 27.12.2022; Raportin sqarues i datës 12.08.2022 të ....; Porosia online e datës 03.07.2019 nga..... E-mail nga A. Q për M. Gj i datës 26.10.2021; E-mail nga M. Gj për A. Q i datës 26.10.2021; E-mail nga M. Gj për N. B etj. i datës 13.01.2022; E-mail nga N. B për M. Gj etj. i datës 13.01.2022; E-mail nga M. Gj për N. B i datës 13.01.2022; E-mail nga M. Gj për B. F i datës 27.10.2021; E-mail nga M. Gj për M. Gj i datës 04.07.2019; E-mail nga M. Gj për K. B i datës 18.03.2022; E-mail nga O. K për B. F i datës 16.03.2022; E-mail nga Y. G për O. K i datës 16.03.2022; E-mail nga A. K për O. K i datës 03.03.2022; E-mail nga M. Gj për B. F i datës 14.01.2022; E-mail nga M. Gj për B. F i datës 20.01.2022; E-mail nga B. F për M. Gj i datës 20.01.2022; E-mail nga M. Gj për B. F i datës 20.01.2022; E-mail nga M. Gj për B. F i datës 21.01.2022; E-mail nga N. B për A. Q etj. i datës 21.11.2019; E-mail nga O. K për M. Gj i datës 21.11.2019; E-mail nga M. Gj për A. Q etj. i datës 21.11.2019; E-mail nga M. Gj për A. Q etj. i datës 19.11.2019; E-mail nga A. Q për M. Gj etj. i datës 15.11.2019; E-mail nga O. K për F. Th i datës 15.11.2019; E-mail nga E. P për O. K i datës 15.11.2019; E-mail nga M. Gj për V. Z etj. i datës 01.04.2022; E-mail nga M. Gj për V. Z i datës

26.01.2022; E-mail nga M. Gj për B. F i datës 27.10.2021; E-mail nga M. Gj për M. Gj i datës 04.07.2019; E-mail nga M. Gj për F. H etj. i datës 18.07.2021; E-mail nga P. N për F. H etj i datës 17.07.2021; E-mail nga M. Gj për A. K etj. i datës 14.07.2022; E-mail nga M. Gj për V. Z etj. i datës 07.06; E-mail nga M. Gj për V. Z etj. i datës 19.05.2022; E-mail nga M. Gj për A. Q i datës 18.05.2022; E-mail nga M. Gj për A. Q i datës 18.05; E-mail nga M. Gj për A. U i datës 17.05.2022; E-mail nga A. U për L. B i datës 17.05.2022; E-mail nga A. U për Msh. i datës 17.05.2022; E-mail nga M. Gj për Xh. S i datës 10.05.2022; E-mail nga M. Gj për O. K i datës 04.05.2022; E-mail nga M. Gj për O. K etj. i datës 08.03.2022; E-mail nga O. K për B. F i datës 04.03.2022; E-mail nga A. K për O. K i datës 03.03.2022; E-mail nga M.GJ. për O.K. i datës 08.03.2022; E-mail nga O.K. për B.F. i datës 04.03.2022; E-mail nga A.K. për O.K. i datës 03.03.2022; E-mail nga M.GJ. për V.Z. etj. i datës 01.04.2022; E-mail nga M.GJ. për V.Z. etj. i datës 29.03.2022; E-mail nga M.GJ. për F.M. i datës 16.03.2022; E-mail nga F.M. për M.GJ. i datës 16.03.2022; E-mail nga M.GJ. për V.Z. etj. i datës 03.03.2022; E-mail nga M.GJ. për F.H. etj. i datës 03.03.2022; E-mail nga M.GJ. për V.Z. etj. i datës 26.01.2022; E-mail nga M.GJ. për P.B. etj. i datës 14.01.2022; E-mail nga M.GJ. për B.F. i datës 12.01.2022; E-mail nga M.GJ. për B.F. i datës 22.12.2021; E-mail nga G.E. për L.Ç. etj. i datës 22.12.2021; E-mail nga M.GJ. për V.Z. etj. i datës 10.11.2021; E-mail nga M.GJ. për V.Z. etj. i datës 04.11.2021; E-mail nga M.GJ. për B.F. i datës 27.10.2021; E-mail nga M.GJ. për M.GJ. i datës 04.07.2019; E-mail nga M.GJ. për B.F. i datës 18.10.2021; E-mail nga M.GJ. për V.Z. etj. i datës 07.10.2021; E-mail nga M.GJ. për B.F. etj. i datës 07.10.2021; E-mail nga M.R. për M.Sh. i datës 07.10.2021; E-mail nga M.GJ. për V.Z. etj. i datës 06.10.2021; E-mail nga M.GJ. për B.F. i datës 29.09.2021; E-mail nga M.GJ. për B.F. i datës 29.09.2021; E-mail nga M.GJ. për S.K. i datës 29.09.2021; E-mail nga O.K. për F.Th. i datës 09.01.2020; E-mail nga Y.P. për O.K. i datës 09.01.2020; E-mail nga G.N. për E.P. i datës 24.12.2019; E-mail nga M.GJ. për M.GJ. i datës 29.09.2021; E-mail nga O.K. për F.Th. i datës 17.01.2020; Shkresë e Unicef e datës 31.07.2019; Shkresë e Unicef e datës 31.07.2019; Shkresën e Unicef ¼ faqe e datës 31.07.2019; Shkresën e Unicef 1/5 faqe e datës 03.03.2022; Shkresën e Unicef 1/8 faqe e datës 31.07.2019; E-mail nga M.GJ. për V.Z. etj. i datës 16.08.2022; E-mail nga M.GJ. për A.Q. i datës 25.10.2021; E-mail nga Xh.S. për M.GJ. i datës 25.10.2021; Raportin tre mujorit të parë Janar-Mars sipas komunave; Raportin krahasues gjashtë mujor Janar-Qershor i rasteve për vitin 2019, 2020, 2021; shkresën Pacientat aktual të TB të shtrirë në spitale regjionale.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankueses *është e pa bazuar, sepse:*

Nga administrimi i provave të lëndës rezulton së ankuesja është e punësuar në Ministrinë e Shëndetësisë dhe së e njëjta ushtron pozitën *Zyrtare Profesionale-Koordinator i Programit Kombëtar të Kontrollit të Tuberkulozit* në kuadër të Divizionit për Shërbime të Veçanta Shëndetësore.

Me tej, nga shkresat e lëndës rezulton së Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Shëndetësisë, me datë 12.08.2022 ka parashtruar kërkesë të Komisioni Disiplinor pranë kësaj ministrie lidhur me inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses, me dyshimin së e njëjta ka kryer shkelje të rëndë të detyrave të punës sipas nenit 46 paragrafi 3 pika 3.1, 3.2 dhe 3.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë.

Komisioni Disiplinor me Vendimin Nr.01/IX/2022 të datës 12.09.2022 ka shpallur përgjegjëse ankuesen për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrarët Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore *“Ndalim të 30% të pagës për një periudhë prej katër (4) muajve”*.

Këshilli duke vendosur sipas ankesës së ankuesit të datës 14.10.2022 të ushtruar kundër Vendimit N.01/IX/2022 të datës 12.09.2022 të Komisionit Disiplinor, ka anuluar vendimin e kundërshtuar dhe çështjen e ka kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë, i cili në riprocedurë më Vendimin Nr.02/XII/2022 të datës 27.12.2022, serish ka shpallur përgjegjëse ankuesen për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, duke i shqiptuar masën disiplinore "Ndalim të 30% të pagës për një periudhë prej katër (4) muajve".

Ankuesja brenda afatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil duke kontestuar ligjshmërinë e Vendimit Nr. 02/XII/2022 të datës 27.12.2022 të Komisionit Disiplinor mbi bazën së i njëjti derivon me shkelje të dispozitave lidhur me procedurën administrative, pasi qe është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ dhe është në kundërshtim me ligjin material. Me tej, shton së Komisioni Disiplinor në mënyrë jo objektive dhe pa argumente dhe fakte konstaton së ankuesja ka dështuar në planifikimin real rreth numrit të pacienteve dhe sasinë e planifikuar, sepse procesi i planifikimit, porosia, prokurimi, ardhja, deponimi dhe shpërndarja e barnave antituberkular është proces zingjiror sepse kanë rol dhe përgjegjësi edhe zyrtarë tjerë e jo individ. Ankuesja shton se nuk ka qasje në SMSF/Sistemin e Menaxhimit të Stokut Farmaceutik ku vlerësohet së a ka sasi te barnave, kur skadojnë dhe kur behet porosia, por në këtë sistem kanë qasje vetëm zyrtaret e Divizionit Farmaceutik dhe së unë nuk jam menaxhere e kontratës, rrjedhimisht planifikimet behën nga regjionet dhe unë këto kërkesa për barna i përcjella tek Divizioni i Farmacisë të cilët në bazë të qasjen në sistem vlerësojnë gjendjen e stokut dhe skandencen e barnave si dhe kontrollojnë dhe miratojnë kërkesat për furnizim me barna. Mungesa e barit për përudhen 4-12 korrik në Klinikën e Pomologjisë ka ndodhur si rezultat i rritjes se numrit të pacienteve me tuberkuloz ndërsa në vitin 2020 dhe 2021 për shkak të pandemisë ka pasur numër të vogël të rasteve kur paciente dhe familjaret kanë kërkuar pajisje me barna antiTB, andaj edhe nuk kemi bërë planifikim për blerje për këto dy vite pasi ka pas barna me afat të skadences. Kërkon që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të anulohet vendimi i kundërshtuar më ankesë.

Në kuptim të vendosjes meritorie lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë lidhur me procedurën dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, gjegjësisht:

Nenin 45 më të cilin është përcaktuar se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit".

Nenit 46, i cili trajton shkeljet disiplinore ku përcakton se: "shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta, Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasojë të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrë; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve

që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë”.

Nenit 47 paragrafi 1 më të cilin është përcaktuar se: “Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”.

Nenit 48 i cili ka përcaktuar se: “1. Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë. 3. Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor”.

Bazuar në kuadrin ligjor si me sipër, Kolegji i këshillit ka analizuar Vendimin Nr.02/XII/2022 të datës 27.12.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë dhe si rrjedhojë konstatoi se Komisioni Disiplinor ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike me rastin e vërtetimit të përgjegjësisë disiplinore të ankueses, sepse, bazuar në vlerësimin e provave të lëndës rezultoi se Udhëheqësi i Divizionit të Farmacisë me datë 22.09.2021 ka kërkuar nga Drejtori i DSHSH dhe Udhëheqësi i Divizionit për Shërbimeve të Veçanta Shëndetësore, informata lidhur me stokun momental të barnave antiTB nëpër qendra si dhe planifikimin për furnizim, pasi që për disa muaj radhazi nuk ka pranuar raport lidhur me përdorimin dhe shpenzimin e barnave antiTB. Kurse, ankuesja përmes përgjigjes së datës 23.09.2021 ka informuar Drejtorin e DSHSH dhe Udhëheqësin e Divizionit për Shërbimeve të Veçanta Shëndetësore së “... Planifikimet dhe kërkesat dërgohen në DF dhe me miratimin e tyre dhe në cc Programi Kombëtar tërhiqet sasia. Ajo që vlen të ceket është së barna ka mjaftueshëm dhe me datë të skadimit deri në vitin 2023”. Në kundërshtim me përgjigjen e ankueses udhëheqësi i Farmacisë Qendrore në SHSKUK me datë 20.10.2021 ka informuar së ka skadim të barnave antiTB në Spitalet e Përgjithshme duke kërkuar rishqyrtim të planifikimit për të evituar skadimin. Me tej sipas shkresave të lëndës vërehet së më datë 12.07.2022 Drejtori i Klinikës së Pulmologjisë-QKUK Prishtinë, ka njoftuar për mungesë të barnave antiTB (Rifampicine 300 mg dhe tableta izoniazid 30 mg) në Klinikën e Pulmologjisë duke shtuar së përkundër këkesës së vazhduar të menaxheri kombëtar i Tuberkulozit, javën e fundit pacientet kanë mbetur pa terapi tuberkulare që është mjaft shqetësuese për shkak të ndërprerjes së mjekimit, andaj mbi gjendjen e këtyre fakteve dhe nisur nga rëndësia e barnave TB për pacientet e sëmur me TB, Kolegji vlerëson së ka dështim në menaxhimin e duhur të gjendjes së stokut farmaceutik për barnat antiTB si dhe në planifikimet për furnizim të rregullt me barna antiTB.

Lidhur me pretendimin ankimor së procesi i planifikimit, porosia, prokurimi, ardhja, deponimi dhe shpërndarja e barnave antituberkular është proces zingjiror sepse kanë rol dhe përgjegjësi edhe zyrtarë tjerë e jo individi, Kolegji ka analizuar përshkrimin e detyrave të punës së ankueses në cilësinë e Koordinatorit të Programit Kombëtar të Kontrollit të Tuberkulozit ku është përcaktuar se: *Ndihmon në hartimin e dokumenteve të politikave/strategjive dhe legjislacionit në lëmin e parandalimit, diagnostikimit dhe mjekimit të tuberkulozit; koordinon dhe mbështet mekanizmat e koordinimit në lëmin e parandalimit, diagnostikimit dhe mjekimit të tuberkulozit; monitoron ofrimin e shërbimeve efektive dhe të koordinuara në lëmin e parandalimit, diagnostikimit dhe mjekimit të Tuberkulozit; monitoron cilësinë e menaxhimit të institucione shëndetësore në sektorin e shërbimeve shëndetësore për parandalimin, diagnostikimin dhe mjekimit të Tuberkulozit...*. Në këtë kontest Kolegji mori parasysh edhe Rregulloren Nr.07/2015 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Ministrisë së Shëndetësisë, ku me nenin 17 janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e

Divizionit të Shërbimeve të Veçanta Shëndetësore ku citohet se; “ 1.1.Ndihmon në hartimin e dokumenteve të politikave/strategjive dhe legjislacionit në sektorët e mjekësisë së punës, mjekësisë sportive, mjekësisë fizikale dhe rehabilitimit, si dhe parandalimit dhe mjekimit të Tuberkulozes dhe HIV/AIDS-it; 1.2.Koordinon dhe mbështetë mekanizmat e koordinimit në sektorët e mjekësisë së punës, mjekësisë sportive, mjekësisë fizikale dhe rehabilitimit, si dhe parandalimit dhe mjekimit të Tuberkulozes dhe HIV/AIDS-it; ..... kurse me nenin 21 të të njëjtës rregullore janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të Farmacisë ku thuhet së: 1.1.Pranon dhe analizon kërkesat e institucioneve shëndetësore nga lista esenciale e barërave dhe materialit shpenzues përfshirë parashikimet e kostos, për secilin vit fiskal për Kujdesin Parësor Shëndetësor (KPSH); 1.2.Përpilon planin vjetor i nevojave për prokurim të barërave dhe materialit shpenzues nga LEB në bazë analizës së nevoja të popullatës, kërkesave të institucioneve shëndetësore, prioriteteve dhe mundësive materiale të MSh, për KPSH; 1.3.Koordinon dhe përkrah përpilimin, rishikimin periodik të Listës Esenciale të Barnave; 1.4. Monitoron dhe ofron përkrahje profesionale në ekzekutimin e kontratave të furnizimit me barëra dhe material shpenzues; 1.5. Monitoron stoqet e barërave në Depot e Ministrisë së Shëndetësisë dhe siguron furnizimin e rregullt dhe të pandërprerë me barna dhe material shpenzues të disponueshëm për institucionet shëndetësore publike të KPSH;...” rrjedhimisht Kolegji erdhi në përfundim së është i pakontestueshëm fakti së ankuesja është përgjegjëse për zbatimin e politikave për parandalimin, diagnostikimin e hershem dhe trajtimin e tuberkulozit, duke përfshirë identifikimin me kohë dhe të saktë të kërkesave për furnizimin me barna antiTB nga institucionet shëndetësore, si dhe menaxhimin e vazhdueshëm të disponueshmerisë me barna tuberkular si mekanizma thelbësore në parandalimin dhe mjekimin e sëmundjeve tuberkulare, ndërsa, Divizioni i Farmacisë është njësi përgjegjëse për furnizim me barna në pajtim me procedurat ligjore të furnizimit, kështu që pretendimi ankimor mbi këtë bazë nuk ka mbështetje ligjore.

Referuar rrethanave dhe konstatimeve si me lart, Kolegji i Këshillit thekson edhe faktin së zbatimi i politikave shëndetësore, bie në përgjegjësi të hirarkike se tërë sistemit ministror shëndetësor, duke filluar nga institucionet shëndetësore, udhëheqësit e njësive kompetente të MSH-së deri të Sekretari i Përgjithshëm i MSH-së si nëpunës më i lartë civil, përgjegjës për drejtimin e të gjithë veprimtarisë administrativo-profesionale të sistemit ministror.

Përkritazi me pretendimin së vendimi i kundërshtuar më ankesë është nxjerrë në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ, Kolegji nga analizimi i Vendimit Nr.02/XII/2022 të datës 27.12.2022 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Shëndetësisë, ka konstatuar së i njëjti përmban të gjitha elementet e detyrueshme të aktit administrativ të përcaktuar me nenin 47 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe së arsyetimi i vendimit përmban shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, dhe bazën ligjore të vendimit, andaj, si rrjedhojë është i pabazuar pretendimi ankimor i ankuesit në këtë kuptim.

Nga shqyrtimi i provave të administruara gjegjësisht sipas emailit të datës 22 janar 2021 dhe emailit 19.05.2022 të zyrtares rezulton së në emër të ankueses është hapur llogari në SMSF, më ç’rast të njëjtës i është përcjell edhe manuali i përdorimit lidhur me rolin e saj si menaxhere e kontratës, kështu që nuk qëndron pretendimi ankimor së ankuesja nuk ka qasje në SMSF/Sistemin e Menaxhimit të Stokut Farmaceutik. Ndërlidhur me këtë pretendim ankimor, Kolegji thekson faktin së mungesa e qasjes në SMSF, nuk përjashton përgjegjësinë e ankueses që e njëjta në baza të caktuar dhe të rregullta kohore të kërkoj raporte dhe informata me shkrim nga njësia përgjegjëse në këtë rast Divizioni i Farmacisë lidhur me gjendjen e stokut të barnave tuberkular dhe skadencën e tyre.


Kolegji me rastin e trajtimit të pretendimeve ankimore mori parasysh edhe konstatimet sipas Raportit të Avokatit të Popullit me numër protokolli 113/2021 të datës 27.10.2021, rasti 698/2020 në lidhje më me qasjen në shërbime shëndetësore të personave të prekur me virusin HIV/AIDS dhe me Tuberkuloz(TB) gjatë periudhës së pandemisë COVID-19 në Kosovë, ku me pikën 88 të këtij raporti është konstatuar shkelje të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut meqenëse autoritetet përkatëse nuk kanë arritur t'i përmbushin detyrimet kushtetuese kundrejt personave të infektuar ne HIV/AIDS dhe TB.


Nisur nga konstatimet si me lartë, Kolegji vlerëson së nëpunësja civile Majlinda Gjocaj ka vepruar në kundërshtim me nenin 25 të Ligjit Nr. 06/1 -114 për Zyrtarët Publik, ku përcaktohet se: 1.Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës.3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike, ndërsa, Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Shëndetësisë, me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.02/XII/2022 të datës 27.12.2022 të datës 27.12.2022 ka vepruar në pajtim me dispozitat Ligji Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publike.

Theksuar si me lart, e në mbështetje të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.280/2023

Çlirim Zeka  
  
Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj Demi  
  
Kryetare e Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses avokatit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Shëndetësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.